

## Arritje të Këshillit të Investimeve, 2019-2020

Deri më sot, nga KI janë aprovuar gjithsej 204 rekomandime<sup>1</sup> mbi përmirësimin e klimës së investimeve, nga të cilat 34% aktualisht rezultojnë të përmbushura. Gjatë vitit 2019 dhe muajve të parë të 2020, janë marrë në konsideratë 48 rekomandime të KI nga disa prej institucioneve përgjegjëse dhe përmes aktiviteteve e inicativave të tyre pati ecuri pozitive mbi:

Reformën mbi Informalitetin, ku theksojmë miratimin e VKM-së Nr. 415, datë 19.6.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese” që synon formalizimin në sektorin e turizmit përmes kategorizimit imperativ të strukturave turistike që veprojnë në këtë sektor. Për më tepër, vlerësohet plani operacional ndaj informaliteti i ndërmarrë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe prezantimi i aplikacionit Inovativ "Stop Informalitetit". Përtej këtyre masave pozitive, efekt të qëndrueshëm dhe afatgjatë do kishte *përgatitja dhe miratimi i një Strategjie të mirëfilltë kundër ekonomisë informale*, e cila të shoqërohet me një plan veprimi, me qasje sektoriale, afate kohore dhe institucione përgjegjëse të mirëpërcaktuara, të konsultuara dhe bashkërenduara me përfaqësuesit e biznesit.

Reformën e Deregulimit, përmes thjeshtimit të procedurave nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me zbatimin e procedurës "Dogana pa Letra" që ndikon 93% të të gjithë subjekteve që operojnë me doganën. Për më tepër, gjatë këtij viti ka patur rritje të nivelit të përdorimit të numrit të aplikimeve dhe vërtetimeve të lëshuara krejtësisht online nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave. E-shërbimet kanë vijuar të shtohen përmes portalit e-Albania edhe në 2020 duke lehtësuar aksesueshmërinë në shërbime gjatë periudhës së Cov19. *Rekomandime të përcaktuara akoma në drejtim të kësaj reforme lidhen me dixhitalizimin e regjistrave të disa institucioneve kyçe* që do lehtësonte barrën administrative përmes kalimit online të shërbimeve të këtyre institucioneve.

Përshejtimin e zgjidhjes së problematikës së pronësisë mbi tokën, përmes aprovimit të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton normat mbi regjistrimin e titujve të pronësisë, përfundimin e procesit të kalimit të tokës bujqësore përdoruesve të tyre, rregullimin e marrëdhënieve të pronësisë në territoret e cilësuar si “zona me përparësi zhvillimin e turizmit”, inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit, përditësimin e inventarëve të pronave të paluajtshme të pushtetit qendror e vendor, etj. Besueshmëria ndaj suksesit të reformës do të varet gjithashtu edhe nga monitorimi i performancës së saj dhe jo vetëm nga ligjet dhe rregulloret e përcaktuara në letër, ndaj me mjaft ndikim do ishte, krijimi i instrumentave monitorues të reformës dhe të respektimit të afateve, si p.sh. ngritja e një Komiteti Monitorues, edhe me përfaqësues nga biznesi (p.sh. sektori bankar), BSH, shoqatat e biznesit, dhe shoqëri civile për të mundësuar jo vetëm transparencën e fondeve, por edhe dhënien e sugjerimeve në lidhje me përballimin e sfidave të një reforme kaq kritike për ekonominë e vendit.

Reformimin e inspektimeve, kryesisht në drejtim të unifikimit të praktikave administrative mbi inspektimet në nivelin qendror dhe lokal. Për më tepër, janë ndërtuar listat e verifikimeve për të gjithë inspektoratet dhe ndërmarrë trajnime të inspektorëve mbi procesin e inspektimit

<sup>1</sup> KI ka mbajtur 20 mbledhje (2015-2020) me tema me rëndësi prioritarë për lehtësimin e të bërit biznes dhe përmirësimin e klimës së investimeve.

online. Mbetet akoma *sfidë (1) forcimi i bashkëpunimit mes inspektorateve dhe ndërmarrja e inspektimeve të përbashkëta* duke reduktuar numrin e inspektimeve në biznese dhe *(2) përmirësimi i procesit të apelimeve që duhet të unifikohet për të gjithë inspektoratet.*

Publikimin e vizionit, misionit, objektivave dhe politikave në sektorin e turizmit përmes aprovimit të "Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 - 2023". Kjo strategji shtron terrenin drejt formalizimit dhe zhvillimit të këtij sektori. Mjaft të rëndësishme për zhvillimin e këtij sektori do ishte edhe marrja në konsideratë e rekomandimeve të KI si *(1) lehtësimi i kuadrit ligjor për praktikantët dhe punonjësit sezonalë* që duhet të përshtatet me natyrën e kësaj skeme punësimi. *(2) paketat për trajnim e stafit* në sektorin e turizmit mund të jenë pjesë e një programi të veçantë në Skemën e Qeverisë për Punësim Aktiv *(3) përgatitja profesionale e administratës tatimore, por edhe për inspektoratet e ndryshme në nivel qendror dhe vendor, që të monitorojnë përputhshmërinë me kërkesat rregullatore dhe fiskale.*

Ndryshimet ligjore që nxisin incentiva fiskale në drejtim të thjeshtëzimit të TVSH-së për operatorët e sektorit bujqësor si p.sh. skema e kompensimit të TVSH për prodhuesit bujqësorë që u rishikua nga 20% në 6% për këtë kategori apo përjashtimi nga skema e TVSH e subjekteve që furnizojnë me inpute bujqësore (plehrat, pesticidet, farat, fidanët etj). Një sfidë e vazhdueshme që na është adresuar nga komunikimi me biznesin në të gjitha mbledhjet e KI, është *nevoja për stabilizimin e legjislacionit fiskal dhe reduktimi i ndryshimeve të shpeshta në kuadrin ligjor.*

Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike, në lidhje me implementimin e rekomandimeve, të ndjekura përmes formalizimit të tre grupeve të punës ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Deri më tani janë organizuar takime të vazhdueshme me fokus tre sektorë si Bujqësia dhe Agropërpunimi, Energjitika e TIK. Për më tepër, u koordinuan takime mbi problematikën e bllokimit dhe zhbllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesve, nga bankat e nivelit të dytë si dhe mbledhje konsultuese mbi disa shqetësime të ngritura nga biznesi në lidhje me vendosjen e taksave dhe tarifave vendore nga pesë bashki.

Mbështetje mbi inovacionin për rininë dhe kompanitë fillestare në sektorin e TIK përmes nxitjes së investimeve të reja në qendra teknologjie informacioni (IT Hubs) si psh. "Tech Hub" etc. Disa rekomandime për tu sjellë në vëmendje lidhen me sektorin e BPO-ve, ku mjaft e rëndësishme mbetet *(1) një vizion i qëndrueshëm Shtet-Biznes në lidhje me sektorin, (2) strukturimi i bashkëpunimit Ministri-Universitete-Biznes (3) përmirësimi i cilësisë së kurrikulave.*